



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova



# Hartimi i Planit për Mirëmbajtjen dhe Planit për Invesime në Hapësira të Hapura Publike

Hartimi i Planit për Mirëmbajtjen dhe  
Planit për Invesime në  
Hapësira të Hapura Publike

Udhëzues për komunat në Kosovë



## *Falënderimet*

Ky udhëzues është përgatitur nga Helvetas-Swiss Intercooperation Kosovë (HSI-K)/DEMOS, bazuar në përvojën e komunave partnere të projektit gjatë procesit të hartimit të Planeve të Mirëmbajtjes dhe Planeve për Investime në hapësira të hapura publike(HHP).

Udhëzuesi është shkruar nga këshilltarët Bajram Shefkiu dhe Besnik Keka (CDF/DEMOS), në bazë të përvojës së fituar gjatë hartimit të planeve, kontributit të zyrtarëve komunalë të komunave partnere dhe të zyrtarëve të projektit të DEMOS-it:

1. **Majlinda Jupolli**, zyrtare HSI-K/DEMOS
2. **Teuta Jaha-Hoxha**, zyrtare HSI-K/DEMOS
3. **Rrona Berisha**, Praktikante në HSI-K/DEMOS

Udhëzuesi është përgatitur me qëllim që t'i shërbejë jo vetëm komunave partnere të DEMOS-it por edhe të gjitha komunave tjera të Kosovës për t'i hartuar Planet e Mirëmbajtjes dhe Planet për investime në HHP për komunat e tyre respektive. Për këtë qëllim, gjatë hartimit të tij, janë konsultuar anëtarët e kolegjiut të Asociacionit të Komunave të Kosovës për shërbime publike dhe kolegjiut për urbanizëm, të cilët kanë kontribuar me propozimet e tyre për finalizimin e këtij dokumenti.

## Lista e shkurtesave:

<b>PMHHP</b>	Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike
<b>PIHHP</b>	Plani Investiv për Hapësira të Hapura Publike
<b>GP</b>	Grupi Punues
<b>GK</b>	Grupi Koordinues
<b>GIS</b>	Geographical Information System - Sistemi Gjeografik Informativ
<b>HHP</b>	Hapësirat e Hapura Publike
<b>PZhK</b>	Plani Zhvillimor Komunal
<b>PZHU</b>	Plani Zhvillimor Urban
<b>PRrU</b>	Plani Rregullues Urban
<b>TP</b>	Takime punuese
<b>IK</b>	Investime Kapitale

# Tabela e përmbajtjes

<b>1. Hyrje</b> .....	<b>7</b>
1.1. .Mirëmbajtja e hapësirave publike .....	7
1.2. .Planet për mirëmbajtjen e HHP-ve .....	8
1.3. .Rreth udhëzuesit .....	8
<b>2. Hapat për Përpilimin e PMHHP DHE PIHHP</b> .....	<b>11</b>
2.1. .Hapat bazë të planifikimit .....	11
2.2. .Krijimi i strukturave organizative.....	11
<b>3. Hapi i parë – Vlerësimi i gjendjes ekzistuese</b> .....	<b>13</b>
3.1. .Hartimi i listës së HHP-ve komunale .....	14
3.2. .Krijimi i bazës së të dhënave/inventarit të HHP-ve .....	15
3.3. .Analiza e gjendjës së HHP-ve.....	16
3.4. .Analiza e shërbimeve operacionale të mirëmbajtjes .....	17
3.5. .Metodologjia për krijimin e bazës së të dhënave për HHP .....	19
3.6. .Analiza e të dhënave për investimet kapitale në HHP .....	21
<b>4. Hapi i dytë – Vizioni dhe objektivat</b> .....	<b>21</b>
<b>5. Hapi i tretë – Koncepti</b> .....	<b>22</b>
<b>6. Plani Financiar</b> .....	<b>22</b>
<b>7. Aprovimi i Planit dhe raportimi i zbatimit të Planit</b> .....	<b>23</b>
<b>8. Monitorimi dhe rishikimi i Planit</b> .....	<b>23</b>
8.1. .Evidenca dhe raportimi i punëve në mirëmbajtjen e HHP-ve.....	24
<b>9. Ndërgjegjësimi publik</b> .....	<b>25</b>
<b>10. Plotësimi dhe revidimi i PMHHP dhe PIHHP</b> .....	<b>25</b>
Shtojca 1: .....	27
Shtojca 2:.....	30
Shtojca 3:.....	31
Shtojca 4:.....	32

## Lista e tabelave

Tab. 1: Grupet e brendshme - Përshkrimi i roleve dhe përfshirja në plan .....	9
Tab. 2: Grupet e jashtme - Përshkrimi i roleve dhe përfshirja në plan .....	10
Tab. 3 Anëtarët e Grupit Koordinues dhe përshkrimi i detyrave të tyre.....	12
Tab. 4 Anëtarët e Grupit Punues dhe përshkrimi i detyrave të tyre.....	12
Tab. 5: Përfshirja e aktiviteteve të mirëmbajtjes.....	15
Tab. 6: Tabelat e inventarizimit të HHP-ve .....	30
Tab. 7: Forma e monitorimit të HHP-ve .....	31

## Lista e figurave

Fig. 1: Analiza e HHP-ve.....	14
Fig. 2: Inventarizimi i HHP-ve – QGIS .....	16
Fig. 3: Inventarizimi i HHP-ve - Harta bazë.....	17
Fig. 4: Analizimi i shërbimeve .....	18
Fig. 5: Raporti .....	20
Fig. 6: Mirëmbajtja e HHP-ve .....	20
Fig. 7: Shpenzimet e aseteve.....	22
Fig. 8: Harta tematike .....	27
Fig. 9: Harta tematike - Zona urbane .....	28
Fig. 10: Harta tematike/Kategorizimi I HHP-ve.....	29

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

# 1. HYRJE

## 1.1. Mirëmbajtja e hapësirave publike

Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike (PMHHP) mundëson adresimin adekuat të nevojave në hapësirat e hapura publike dhe përcaktimin adekuat të aktiviteteve të mirëmbajtjes. Plani i mirëmbajtjes shtjellon dhe ilustron mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike (HHP) në vazhdimësi, bazuar në të gjitha aktivitetet e parapara e që janë të domosdoshme për një mirëmbajtje të mirëfilltë, si dhe procedurat e monitorimit dhe të zbatimit të tij.

Udhëzuesi i përgatitur është rezultat i përvojës së projektit DEMOS në hartimin e planeve të mirëmbajtjes dhe planeve për investime në HHP me partnerët komunal nga Drejtoritë e Shërbimeve Publike, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

### Menaxhimi i HHP-ve në Kosovë

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, komunat janë përgjegjëse për planifikimin, investimet dhe mirëmbajtjen e HHP-ve brenda territorit të tyre. Zhvillimi i qyteteve në dekadat e fundit të shekullit XX-të dhe në vitet e para të këtij shekulli ka dështuar të reflektojë rolin dhe rëndësinë e HHP-ve për jetën e qytetarëve. Gjersa Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjëse për hartimin e projekteve për rigjallërimin e HHP-ve dhe krijimin e hapësirave të reja, Drejtoritë për Shërbime Publike janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e HHP-ve.

**Nga evidentimi paraprak, në përgjithësi, cilësia jo e mirë e mirëmbajtjes së HHP-ve është pasojë e:**

- Mungesës së komponentës së mirëmbajtjes së detajuar me përshkrimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së HHP-ve në fazën e planifikimit (te HHP-të e reja);
- Strukturës së menaxhimit (personelit të limituar të drejtorisë përkatëse)
- Buxhetit;
- Përkrahjes politike;
- Bazës së të dhënave për HHP-të;
- Pjesëmarrjes së ultë të komunitetit gjatë planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve.

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

## 1.2. Planet për mirëmbajtjen e HHP-ve

- a. **Plani për Mirëmbajtjen e HHP-ve (PMHHP)** është dokument afatmesëm i cili i mundëson komunës të menaxhojë mirëmbajtjen e HHP-ve në mënyrë më efikase dhe më cilësore.
- b. **Plani për Investime në HHP (PIHHP)** është dokument afatmesëm i cili i mundëson komunës t'i planifikojë investimet e komunës në rigjallërimin e HHP-ve ekzistuese dhe krijimin e HHP-ve të reja.

## 1.3. Rreth udhëzuesit

Udhëzuesi për përgatitjen e planeve të mirëmbajtjes ka për objektiv ofrimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e planeve për mirëmbajtjen e HHP-ve dhe planeve për investime në HHP. Për më tepër, udhëzuesi mund të shërbejë si një instrument ndihmës për drejtoritë përkatëse që dëshirojnë ta analizojnë gjendjen ekzistuese të menaxhimit me HHP-të dhe t'i identifikojnë dhe vlerësojnë opsionet, metodologjinë dhe kostot financiare për ta përmirësuar gjendjen e HHP-ve.

**Udhëzuesi është përgatitur për t'u përdorur nga:**

- Drejtoritë e Shërbimeve Publike dhe zyrtarët mbrenda qeverisjes lokale;
- Të gjithë profesionistët që do të përfshihen në procesin e përgatitjes së planeve;
- Zyrtarët përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e HHP-ve;
- Autoritetet tjera lokale të cilat luajnë rol në planifikimin dhe zbatimin e planeve.

Meqë HHP-të e vendbanimeve shfrytëzohen nga grupe të ndryshme të komunitetit, është e rëndësishme që ato të mirëmbahen mirë, ashtu që t'i shërbejnë qëllimit për të cilin janë krijuar. Komuniteti duhet të jetë grupi më i rëndësishëm dhe kyç i këtyre planeve.

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

Tab. 1: Grupet e brendshme - Përshkrimi i roleve dhe përfshirja në plan

Grupet e interesit	Roli apo përfshirja në plan
Grupet e brendshme	
Këshillat Komunale të fshatrave dhe të lagjeve, Komiteti për Shërbime Publike, Financa, Planifikim	Kujdestar kryesor i HHP-ve me këshilltarët të cilët përfaqësojnë qytetarët dhe të cilët vendosin për drejtimet strategjike, mirëmbajtjen dhe planifi- kimin e hapësirave publike.
Zyra apo ekipi udhëheqës në kuadër të ekzekutivit	Kujdeset që PMHHP të realizohet ashtu siç është aprovuar dhe që në bazë të vrojtimeve gjatë monitorimit të Planit, t'i udhëzojnë drejtoritë ko- munale për planifikimin afatgjatë financiar dhe të buxhetit për një mirëm- bajtje të qëndrueshme të hapësirave.
Menaxheri/zyrtari përgjegjës për HHP-të	Përgjegjës strategjik i caktuar për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e HHP-ve dhe të Planit të mirëmbajtjes, monitorimin e gjendjes së HHP-ve, monitorimin e planeve për rigjallërimin, monitorimin e zhvillimit të hapësir- ave, të standardeve, dhe për përditësimin e vazhdueshëm dhe periodik të planeve ekzistuese.
Menaxherët/zyrtarët e hapësirave të ndryshme publike/përgjegjës komunalë për mirëmbajtje apo kontraktorë	Përgjegjës për mirëmbajtje ditore, operacionale dhe rutinore, përfshirë planifikimin dhe realizimin kohor të shërbimeve të pastrimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të elementeve të dëmtuara.
Menaxherët/zyrtarët dhe përgjegjësit për ruajtjen e ambientit	Kujdesen që ofrimi i shërbimeve të jetë në nivelin e duhur dhe që projektet për rigjallërimin dhe rindërtime eventuale janë zhvilluar në harmoni me kërkesat ligjore për ruajtjen e ambientit.
Grupi koordinues për menaxhimin me HHP-të	Kujdeset që planifikimi i menaxhimit të HHP-ve është në harmoni me kërkesat për shfrytëzim optimal dhe duke pasur parasysh edhe jetëg- jatësinë apo qëndrueshmërinë e hapësirave dhe entiteteve përbërëse.
Menaxheri financiar	Kujdeset që të sigurohen informacione adekuate financiare gjatë planifikimit dhe që këto informacione t'i ofrohen këshillave apo komiteteve gjegjëse komunale si dhe Kuvendit Komunal për arsyetim të buxhetit të parashikuar.
Auditorët e brendshëm	Monitorojnë dhe sigurojnë që praktika adekuate aplikohen në planifikimin, mirëmbajtjen dhe financimin e HHP-ve dhe mbështesin e sugjerojnë përmirësime eventuale.

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

Tab. 2: Grupet e jashtme - Përshkrimi i roleve dhe përfshirja në plan

Grupet e interesit	Roli apo përfshirja në plan
Grupet e jashtme të interesit	
Komuniteti	Në përgjithësi, të gjithë përdoruesit apo shfrytëzuesit e HHP-ve. HHP-të me elementet përcjellëse i destinohen drejtpërdrejt qytetarëve dhe pa përfshirjen e tyre qofshin ata shfrytëzues apo jo, është thelbësore për të pasur hapësira të hapura publike të suksesshme. Qeverisja komunale duhet ta synojë pro- movimin dhe ta përforcojë pjesëmarrjen e qytetarëve në planifikimin, krijimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe kujdesin lidhur me HHP-të. Pa përfshirjen e qytetarëve, këto shërbime mund të mbesin të parëndësishme, jorelevante dhe të përfundojnë si plane të pazbatueshme.
Grupet e caktuara të shfrytëzuesve nga komuniteti	Shfrytëzuesit e hapësirave të destinuar për aktivitete specifike dhe për grupe specifike, si ato nga komuniteti i sportistëve, fëmijëve dhe grupmoshave të caktuara, klube të ndryshme, etj.
Ofruesit e shërbimeve të ndryshme	Ndërmarrje apo agjenci të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për komunitetin dhe të cilat shfrytëzojnë HHP-të në pronësi komunale.
Kontraktorët dhe operatorët ekonomik	Kujdesen për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes në nivel të kërkuar sipas marrëveshjeve apo kërkesave në kontratat gjegjëse.
Ndërtuesit dhe bizneset e ndërtimit	Mund të jenë një ndër burimet kryesore për të investuar në krijimin e hapësirave të reja publike, në përmirësimin dhe në mirëmbajtjen e atyre ekzistuese.
Shoqëria civile	

## 2. HAPAT PËR PËRPILIMIN E PMHHP DHE PIHHP

### 2.1. Hapat bazë të planifikimit

Procesi për përpilimin e planeve kalon nëpër 4 hapa të cilat janë të prezantuara më poshtë:

#### 1. Hapi i parë - Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

- Hartimi i listës së HHP-ve komunale;
- Krijimi i bazës së të dhënave/inventarit të HHP-ve. Identifikimi i hapësirave; rekomandohet të bëhet duke shfrytëzuar softuerët me sistemet informative gjeografike (GIS);
- Analiza e gjendjes së HHP-ve;
- Analiza e shërbimeve operacionale të mirëmbajtës dhe kontratave ekzistuese;
- Analiza e buxhetit të zotuar për mirëmbajtje dhe kostos së mirëmbajtjes;
- Analiza e të dhënave për investimet kapitale në HHP.

#### 2. Hapi i dytë - Vizionimi

- Identifikimi i objektivave dhe të metave lidhur me HHP-të, përcaktimi i vizionit për mirëmbajtjen dhe investimet në HHP dhe zgjidhjen e problemeve kryesore të tyre.

#### 3. Hapi i tretë - Koncepti

- Të krijohet koncepti për zhvillimin e HHP-ve që do ta udheheq komunën për mirëmbajtje dhe investime në HHP. Koncepti duhet të bazohet në vlerësimet dhe rezultatet e fituara nga dy hapat e mëparshëm, pra të bazohet në gjendjen ekzistuese dhe në vizionin e përcaktuar.

#### 4. Hapi i katërt - Implementimi, monitorimi dhe rishikimi i planit

- Të bëhet përshkrimi i masave kyçe që duhet të ndërmeren që të implementohet koncepti i hartuar për HHP-të. Pas implementimit të planit, e rëndësishme është edhe të definohen aktivitetet monitoruese që të mos ketë degradim të HHP-ve, si dhe të bëhet rishikimi i planit që të jetë në hap me kërkesat e kohës.

### 2.2. Krijimi i strukturave organizative

**Para se të fillohet me aplikimin e këtyre 4 hapave, e rëndësishme është krijimi i strukturave organizative, themelimi i grupit punues (GP) dhe grupit koordinues (GK), që shërben si bazë për fazat e planifikimit dhe të zbatimit të planit.** Detyrat e Grupit Punues dhe Grupit Koordinues duhet të jenë të përcaktuara mirë. Poashtu, rëndësi ka edhe përcaktimi i akterëve kryesor që duhet të përfshihen në procesin e planifikimit. Varësisht nga komuna, në kuadër të Grupit Koordinues duhet caktuar drejtues të drejtorive përkatëse që ndikohen drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë nga plani i ardhshëm. Në kuadër të Grupit punues, rekomandohet të caktohen anëtarë të drejtorisë bartëse të planit, përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e HHP-ve, gjegjësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, zyrtarët e së cilës kanë përvojë në hartimin e planeve dhe që kanë

Hyrije	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

njohuri për dokumentet zhvillimore komunale, në veçanti në fushën e mjedisit . Gjithashtu, pjesë përbërëse e Grupit Punues rekomandohet të jetë edhe përfaqësuesi nga Drejtoria e Financave me qëllim analizimin e investimeve në HHP dhe në mirëmbajtjen e tyre.

Tab. 3 Anëtarët e Grupit Koordinues dhe përshkrimi i detyrave të tyre

Anëtarët e Grupit Koordinues	Përshkrimi i detyrave të grupit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryetari / nënkryetari i komunës;</li> <li>• Drejtori i drejtorisë së Shërbimeve Publike;</li> <li>• Drejtori i drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit<sup>1</sup>;</li> <li>• Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike / Kryesuesi i kuvendit komunale;</li> <li>• Drejtorët e drejtorive tjera, sipas nevojës;</li> <li>• Këshilltarët profesionalë të kontraktuar</li> <li>• (Sipas nevojës).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejton procesin e hartimit të planit;</li> <li>• Në bashkëpunim me grupin punues, përcakton periudhën kohore të hartimit të planit;</li> <li>• Monitoron progresin e arritur në hartim në baza të rregullta;</li> <li>• I jep mbështetje politike procesit të hartimit të planit;</li> <li>• Vendos mbi ndarjen e buxhetit gjatë procesit të hartimit në rast nevojë;</li> <li>• Gjen mënyrat për zgjidhjen e problemeve në rast të ndonjë ngecje;</li> <li>• Monitoron përmbushjen e afateve kohore dhe arritjen e objektivave;</li> <li>• Merr vendim për ndarjen e buxhetit për zbatimin e planit gjatë planifikimit të buxhetit vjetor apo kornizës afatmesme buxhetore;</li> <li>• Jep pëlqimin për detyrat e grupit punues dhe validon rezultatet e punës së këtij grupi</li> </ul>

Tab. 4 Anëtarët e Grupit Punues dhe përshkrimi i detyrave të tyre

Anëtarët e Grupit Punues	Përshkrimi i detyrave të grupit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëheqësi i grupit: Drejtori i Drejtorisë për Shërbimeve Publike ose Drejtori Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;</li> <li>• Zyrtari komunal nga fusha e mbrojtjes së mjedisit, inspektimit, shërbimeve publike, e të ngjashëm;</li> <li>• Planeri komunal (arkitekt, gjeodet)</li> <li>• Zyrtari financiar;</li> <li>• Zyrtarët tjerë, sipas nevojës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizon lansimin e procesit të hartimit të planit;</li> <li>• Diskuton dhe vendos për detyrat e grupit;</li> <li>• Përcakton momentet e përfshirjes së publikut në proces;</li> <li>• Mbështet kompanin konsulente me të dhëna dhe informata rreth fushave të caktuara;</li> <li>• Udhëheq me pjesën teknike të procesit;</li> <li>• Përgjegjës për hartimin e planit;</li> <li>• Raporton te grupi koordinues dhe në komitetin për shërbime publike rregullisht mbi ecurinë e procesit.</li> </ul>

### 3. HAPI I PARË – VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Varësisht nga kërkesat komunale për përmbajtjen e planit, formësohet edhe struktura e tij. Pjesët kryesore që duhet të shtjellohen në dokument, bazuar në përvojat, janë përshkruar si në vijim:

**Profili i Komunës:** Pozita gjeografike, territori, numri i banorëve, ndarjet urbane janë të dhëna që duhet analizuar dhe rekomandohen të përshkruhen në pjesën e profilit të Komunës. Gjithashtu, me rëndësi është edhe përshkrimi i objektivave komunale të përcaktuara në Dokumentet Planifikuese Zhvillimore dhe politikat udhëheqëse komunale.

**Funksionet e HHP-ve:** Përveç përshkrimit të funksioneve kyçe të hapësirave të hapura publike, është me rëndësi të përshkruhen funksionet e HHP-ve në raport me strukturën e vendbanimeve dhe rëndësinë e HHP-ve specifike për qytetin/komunën.

**Fushëveprimi i HHP-ve:** Të gjitha sipërfaqet publike me rëndësi për zhvillimin e jetës shoqërore, siç janë: parqet, sheshet, terrenet sportive, këndet e lojërave për fëmijë, sipërfaqet gjelbëruese, shëtitoret, shtretërit e lumenjve, parkingjet, trotuaret, rrethrotullimet, varrezat etj., duhet të përfshihen në inventarizim. Në veçanti, në këtë kapitull duhet të specifikohen hapësirat të cilat planifikohen të trajtohen me këtë plan për periudhën afatmesme.

**Parimet udhëheqëse:** Në këtë kapitull përshkruhen parimet elementare për hartimin e PMHHP-së si pjesë vitale e kornizës së zhvillimit dhe planifikimit lokal me qëllim të përmirësimit dhe ruajtjes së karakterit të hapësirave, duke u fokusuar në mirëmbajtjen cilësore.

Nuk ekzistojnë kërkesa as obligime të posaçme ligjore për autoritetet komunale lidhur me menaxhimin e HHP-ve. Megjithatë, ligjet aktuale siç janë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore, Ligji për Ndërtim, etj., i fuqizojnë dhe i orientojnë autoritetet lokale për menaxhimin e tokës, përfshirë destinimin duke pasur parasysh edhe ruajtjen e shëndetit publik dhe mirëmbajtjen e HHP-ve. Këto dokumente ligjore dhe planifikuese mund të merren edhe si bazë për hartimin e planeve të mirëmbajtjes së HHP-ve si dhe atyre për investime në HHP.

**Dokumentet referuese** për hartimin e planit të mirëmbajtjes janë:

- Ligji për Planifikimin Hapësinor;
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Planet Zhvillimore Komunale dhe Urbane;
- Planet Rregulluese;
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis;
- Ligji për Mbeturina (Nr. 04/L-060);
- Planet apo Rregulloret e ndryshme komunale.

**Situata aktuale dhe analiza:** Varësisht nga përcaktimet komunale, PMHHP-ja dhe PIHHP-ja mund të hartohen si dokumente të ndara apo mund të bashkohen në një dokument të vetëm.



*Fig. 1: Analiza e HHP-ve*

**Për analizën e mirëmbajtjes së HHP-ve** nëpërmjet inventarit dhe analizës së tyre, shtjellohen si në vijim:

- Të dhënat për numrin e HHP-ve,
- Sipërfaqet dhe tipologjia e HHP-ve;
- Gjendja e HHP-ve / cilësia e tyre;
- Menaxhimi;
- Shfrytëzimi;
- Shpenzimet e viteve paraprake në mirëmbajtje, etj.

### 3.1. Hartimi i listës së HHP-ve komunale

Qëllimi i këtij kapitulli të planit është të ofrojë një pamje të përgjithshme dhe të hollësishme të hapësirave të hapura publike. Rezultatet e kësaj analize ofrojnë bazë mbi të cilën do të identifikohen përparësitë, dobësitë, rreziqet dhe mundësitë për mirëmbajtjen adekuate të HHP-ve. Rezultat i këtij veprimi do të duhej të ishte inventarizimi i të gjitha HHP-ve në territorin komunal. Të dhëna të tjera me rëndësi të veçantë janë:

- Të dhënat kadastrale për HHP-të;
- Të dhënat fotografike për secilën HHP.

## 3.2. Krijimi i bazës së të dhënave/inventarit të HHP-ve

Është treguar praktikë e mirë që HHP-të të inventarizohen duke shfrytëzuar softuerët/sistemet gjeografike informative Q-GiS, si softuer i hapur, pa pagese (open source), i cili mund të shkarkohet në linkun <http://www.qgis.org/en/site/forusers/download.html>, e që në këtë rast është përdorur për identifikimin e HHP-ve. Të dhëna të nevojshme për bazën e të dhënave janë: ortofotot komunale, Planet Kadastrale, PZHK, PZHU, PRrU në formatin përkatës që lexohet nga softueri përkatës. Inventarizimi është rezultat i inspektimit të detajuar, evidentimit dhe përditësimit të HHP-ve të grupuara sipas tipologjive, me sipërfaqet e matura, me gjendjen aktuale të vlerësuar, statusin pronësor, etj.

Veçoritë kryesore të HHP-ve, të nevojshme për analiza të mëtutjeshme janë:

- Emri i HHP-ve;
- Kategoria;
- Zona;
- Sipërfaqja;
- Pronësia;
- Përdoruesit;
- Frekuentimi;
- Gjendja e HHP-ve;
- Cilësia e shërbimeve të mirëmbajtjes, etj.

Gjithashtu, është i rëndësishëm përshkrimi i aktivitete të mirëmbajtjes. Tabela në vijim përshkruan aktivitetet kryesore.

Tab. 5: Përfshirja e aktiviteteve të mirëmbajtjes

Nr.	Aktivitetet e pastrimit	Aktivitetet e hortikulturës	Aktivitetet në ambientin e ndërtuar
1	Grumbullimi i mbeturinave	Plehërimi	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane
2	Pastrimi i kanaleve të kullimit	Kositja	Mirëmbajtja e shtigjeve
3	Pastrimi i grafiteve të padëshiruara	Mihja	Riparimet
4	Të tjera	Mbjellja e gjelbërimit të ultë, të mesëm dhe të lartë	Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes
5		Krasitja	Mirëmbajtja e ndriçimit
6		Ujitja	Mirëmbajtja e pajisjeve për lojë
7		Dezinsektimi	Mirëmbajtja e terreneve sportive
8		Të tjera	Mirëmbajtja e fontanave
9			Mirëmbajtja e parkingjeve
10			Përmendoret, pllakat për kujtimore etj.

Udhëzuesi i përdorimit të QGIS, i përgatitur nga konsulentet e DEMOS-it, është dokument me rëndësi që mund të shfrytëzohet nga Grupi Punues për krijimin e bazës së shënimeve për HHP-të. Burimet e të dhënave për hartën bazë mund të sigurohen nga Drejtoria komunale për Kadastër dhe Gjeodezi. Për krijimin e hartës bazë nevojiten të dhënat si në vijim:

- Harta (Shape File) për territorin komunal;
- Parcelat kadastrale për territorin komunal;
- Orthophoto (fotografimi i fundit në posedim të Drejtorisë për Kadastër).

### 3.3. Analiza e gjendjës së HHP-ve

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese konsiston në kryerjen e analizës të përmblëdhur për secilën HHP.




Fig. 2: Inventarizimi i HHP-ve – QGIS

Varësisht nga vendndodhja e HHP-ve dhe karakteristikat e tjera të paracaktuara, duhet bërë kategorizimi i HHP-ve në bazë të prioriteteve komunale në raport me mirëmbajtjen.



*Fig. 3: Inventarizimi i HHP-ve - Harta bazë*

### 3.4. Analiza e shërbimeve operacionale të mirëmbajtjes

Me qëllim të ofrimit të pasqyrës reale të kostos për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, është me rendësi të përgatitet analiza/raporti i të dhënave për tipologjinë e mirëmbajtës, aktivitetet e mirëmbajtës dhe koston për secilin aktivitet. Kostoja e aktiviteve, për tri ose më shumë vite paraprake, do të ofronte bazë për kalkulimet e kostos reale të analizuar në bazë të aktiviteve të mirëmbajtjes.




Fig. 4: Analizimi i shërbimeve

- **Analizimi i i praktikave të deritanishme:**
  - Organizimi i drejtorive përgjegjëse komunale;
  - Metoda e ofritit të shërbimeve (ndërmarrje komunale, operator ekonomik, privat, etj.);
  - Sipërfaqet në të cilat ofrohet shërbimi;
  - Cilësia e shërbimit të mirëmbajtjes.
- **Konsultimi me drejtorit gjegjëse dhe me grupet e interesit:**
  - Vlerësimi i burimeve aktuale nëse janë të mjaftueshme në ekspertizë dhe në inspektim;
  - Ofrimi i trajnimeve adekuate për stafin komunal.
- **Analiza e HHP-ve ekzistuese: sasia, shpërndarja, përshtatshmëria**

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

- **Analiza e aktiviteteve të mirëmbajtjes:**

- Aktivitetet e pastrimit përfshijnë: grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, gjetheve, pastrimin e kanaleve të kullimit, pastrimin e grafitëve, shtigjeve dhe aktivitetet e pastrimit të sipërfaqeve të ndërtuara (me kubëza betoni, asfalt, beton, fontana dhe vepra arti, etj).
- Aktivitetet e hortikulturës përfshijnë: ujitjen, kositjen, mbjelljen, plehërimin, ajrosjen, dez-insektimin, mirëmbajtjen e gjelbërimit të ulët, të mesëm, të lartë, etj.
- Aktivitetet e mirëmbajtjes së ambientit të ndërtuar në kuadër të HHP-ve siç janë: mirëmbajtje/riparime të vogla në shtigje, sipërfaqe të ndërtuara, mobilieri urbane, kënde për lojëra fëmijësh, fontana, sisteme të ujitjes, mirëmbajtje për skulptura dhe vepra të tjera arti, mirëmbajtje e ndriçimit publik, etj.

### 3.5. Metodologjia për krijimin e bazës së të dhënave për HHP

#### Veprimi 1: Identifikimi i nevojave për HHP

**Veprimi 2:** Inspektimi i HHP-ve (Grupi Punues në bashkëpunim me drejtoritë komunale të cilat mund të ofrojnë informacione dhe ekspertizë/Drejtoria e Urbanizmit, Gjeodezisë, Mjedisit etj.)


- Sigurimi i informatave të nevojshme për HHP-të mbrenda fushëveprimit të planit;
- Sigurimi i dokumentacionit kadastral për pronësinë, dokumentacionit fotografik etj.;
- Analiza e të gjitha informacioneve në dispozicion dhe nxjerrja e të dhënave.

#### Veprimi 3: Përcaktimi/adaptimi i standardeve aktuale komunale


- Standardet sasiore - Paraqitja në forme tabelore e të dhënave si: tipologjia, sipërfaqja në ha apo në m<sup>2</sup>, numri i banorëve dhe raporti sipërfaqe/banorë;
- Standardet cilësore - Përshkrim i gjendjes ekzistuese të HHP-ve në aspektin e cilësisë. Vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së HHP-ve me rekomandime për ndërhyrje (nëse e nevojshme të rindërtohen, të rigjallërohen, apo vetëm të mirëmbahen);
- Klasifikimi i HHP-ve - Tipologji të ndryshme të HHP-ve në mënyrë të paevitueshme do të jenë lëndë e Planit të Mirëmbajtjes, si dhe e regjimeve të ndryshme të mirëmbajtjes. Tipologji të caktuara do të përdoren si pjesë e qasjes në menaxhimin, kategorizimin dhe klasifikimin e hapësirave sipas madhësisë dhe funksionit të tyre. Shumica e tipologjive të përmendura paraqiten në mënyrë jostatusore, krijimi i të cilave është inspiruar nga konteksti lokal, nga lloji/tipi i hapësirës, dhe shpesh edhe nga përshtatshmëria për t'u menaxhuar. Ndër problemet e mundshme të cilat mund të paraqiten dhe që duhet të adresohen gjatë identifikimit të tipologjive të hapësirave janë edhe këto në vijim:
  - Konsistenca gjatë definimit;
  - Tejkalimi i rrezikut të numërimit të dyfishtë në rastet kur hapësira të ndryshme mund të jenë të përputhura apo të mbivendosura;
  - Harmonizimi dhe kompatibiliteti i kategorive/tipologjive në kontekstin lokal.
  - Standardet e qasjes në HHP.

**Veprimi 4: Përcaktimi/adaptimi i standardeve komunale për periudhën afatmesme**

- Standardet projektuese
- Standardet sasiore
- Standardet cilësore



*Fig. 5: Raporti*



*Fig. 6: Mirëmbajtja e HHP-ve*

### 3.6. Analiza e të dhënave për investimet kapitale në HHP

Lista e investimeve kapitale për periudhën paraprake ofron një pasqyrë të qartë për qasjen komunale dhe të donatorëve ndaj HHP-ve. Analizimi i projekteve mbi të cilat janë zbatuar projektet e rigjallërimit të HHP-ve është gjithashtu me rëndësi me qëllim identifikimin e pjesëve që duhet plotësuar gjatë investimeve kapitale në HHP-të në të ardhmen.

#### Të dhëna të rëndësishme për PIHHP për analizë:

Të dhënat për shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HHP-ve në vitet paraprake nëpërmjet analizimit të kontratave në raport me cilësinë e mirëmbajtjes në të kaluarën respektivisht në aktivitetet e mirëmbajtjes të ofruara, të dhënat për operatorin, menaxhimin etj. Evidentimi i të metave apo defekteve eventuale, apo konstatimi se të njëjtat janë mirëmbajtur. Nga analiza e kontratave janë identifikuar të metat si në vijim:

- Ndarja joadekuate e zonave/fushave të mirëmbajtjes;
- Numri i ulët i aktivitetet të parapara të mirëmbajtjes;
- Përshkrimet joadekuate të aktiviteteve të mirëmbajtjes;
- Mungesa e specifikimeve teknike;
- Mungesa e planifikimit kohor/dinamik të mirëmbajtjes, etj.

## 4. HAPI I DYTË – VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Përcaktimi i vizionit për mirëmbajtjen/investimet në HHP bazohet në politikat komunale dhe në vizionin zhvillimor të komunës (PZHK) nëse është i përcaktuar dhe duhet të formulohet vetëm për HHP. Vizioni përgatitet nga Grupi Punues në konsultim me Grupin Koordinues dhe grupe të tjera të interesit në punëtorinë e paraparë për vizionim në punëtori publike. Rëndësi të veçantë kanë objektivat e përgjithshme dhe synimet të cilat paraqesin aspiratat e matshme për cilësinë dhe sipërfaqet e hapura publike.

## 5. HAPI I TRETË – KONCEPTI

Në hapin e tretë parashihet të krijohet një koncept për mirëmbajtjen dhe investimet në HHP për një periudhë më të gjatë. E rëndësishme është që koncepti të bazohet në rezultatet e punës deri te kjo fazë, pra të bazohet në vlerësimet e fituara gjatë analizës së gjendjes ekzistuese dhe në vizionin e përcaktuar nga GP dhe GK në bashkpunim me grupet tjera të interesit.

## 6. PLANI FINANCIAR

Për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate të kualitetit të hapësirave kërkohet analizimi dhe planifikimi i buxhetit për investime në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe për investime kapitale në HHP.

### Kapitulli financiar shtjellon:

- Burimin e financimit të investimeve në mirëmbajtje për periudhën afatmesme, bazuar në fush-ëveprimin e planit.
- Burimin e financimit të investimeve në HHP-të e reja bazuar në listën e projekteve me prioritet.

Gjithashtu të dhëna me rëndësi që duhet të sigurohen janë përshkruar si në vijim:

- Investimet aktuale** - në këtë nënkapitull duhet të përshkruhet lista e investimeve kapitale dhe burimi i financimit
- Investimet në HHP-të në vitet paraprake**
- Analiza financiare e shpenzimeve reale për mirëmbajtje** - sipas përcaktimeve të hartuesve të planit (GP dhe GK).
- Analiza e kostos për krijimin e HHP-ve të reja bazuar në investimet në të kaluarën**
- Lista e projekteve për investime kapitale**




Fig. 7: Shpenzimet e asetëve

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

## 7. APROVIMI I PLANIT DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT

Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së jetësimit të planit, në veçanti të Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike, është me rëndësi thelbësore aprovimi në Kuvendin Komunal.

Procesit të hartimit të planit duhet t'i paraprijë inicimi i hartimit të planeve nga Kuvendi Komunal. Drafti final i planeve i dërgohet anëtarëve të Kuvendit Komunal për dhënien e komenteve dhe vërejtjeve eventuale. Varësisht nga procedurat komunale, PMHHP dhe PIHHP duhet t'i nënshtrohen diskutimit publik dhe shqyrtimit publik. Këto procedura do të mundësonin dhënien e kontributeve të qytetarëve dhe vendimmarrësve duke ngritur "pronësinë" e komunitetit ndaj planeve dhe do të siguronte zbatimin e tij.

Raportimi i zbatimit të planit në periudhën kohore të paracaktuar (më së paku 2 herë në vit) do t'i mundësonte anëtarëve të kuvendit komunalë dhe komunitetit përditësimin e gjendjes së HHP-ve dhe identifikimin e fushave ku mund të përmirësohen shërbimet.

## 8. MONITORIMI DHE RISHIKIMI I PLANIT

Ekzistenca e një sistemi të monitorimit në të gjitha nivelet e mirëmbajtjes strategjike të hapësirave dhe krijimi i indikatorëve adekuat si dhe metodave vlerësuese për matjen dhe vlerësimin e HHP-ve është tejet e rëndësishme. Me interes vital është që në mënyrë të saktë të monitorohet gjendja, kushtet dhe ndryshimet evidente në HHP dhe të vlerësohet suksesi i menaxhimit dhe i procesit të mirëmbajtjes. Aktivitetet monitoruese mund të përshkruhen si në vijim:

- Përcaktimi i aspekteve zbatuese të planit;
- Vlerësimi i progresit në zbatimin e planit;
- Analizimi i gjetjeve dhe sistematizimi i tyre;
- Identifikimi i shkaqeve dhe i pasojave eventuale;
- Identifikimi dhe evidentimi i lëshimeve në planin paraprak;
- Përgatitja e raporteve periodike dhe atyre përfundimtare;
- Vizitat dhe inspektimet.

Drejtoritë dhe komitetet gjegjëse do ta vlerësojnë realizimin e planeve dhe suksesin apo mospërfundimin e tyre edhe nëpërmjet treguesve në vijim:

- Vlerat buxhetore në dispozicion;
- Shpenzimet buxhetore për periudhën e vlerësuar;
- Niveli i përmirësimeve të arritura dhe të dukshme në HHP-të ekzistuese;

Hyrje	Hapat për Përpilim	Vlerësimi i gjendjes	Vizioni/Objektivat	Koncepti	
Plani Financiar	Aprovimi i Planit	Monitorimi	Ndërgjegjësimi publik	Plotësimi/Revidimi	Shtojcat

- Niveli i adresimit të drejtë të mangësive në HHP-të ekzistuese;
- Kënaqësia e qytetarëve/komunitetit e vlerësuar me anketa periodike.

Në bazë të indikacioneve dhe vlerësimeve të përmendura më lart mund të vendoset pastaj për ndryshimet eventuale apo plotësimet e planit aktual gjatë planifikimit për fazën pasuese.

## 8.1. Evidenca dhe raportimi i punëve në mirëmbajtjen e HHP-ve

Operatori ekonomik duhet të mbajë shënime mbi punët dhe aktivitetet ditore në një format të aprovuar nga mbikëqyrësi komunal apo nga zyra gjegjëse komunale, në mënyrë që të ofrojë dëshmi për sasi, çmimin, lokacionin dhe detaje të tjera të nevojshme lidhur me shërbimet e ofruara. Të njëjtat përditësohen në bazën e shënimeve dhe në formën për monitorimin e PMHHP.

Korrespondenca me zyrën apo zyrtarin menaxhues duhet të përfshijë të dhëna të mjaftueshme mbi aktivitetin e zbatuar, si:

- Emri apo kodi i HHP-ve;
- Fusha apo zona e mirëmbajtjes;
- Elementi i përmirësuar i HHP-ve, nëse ka ndonjë përmirësim;
- Prioriteti;
- Data dhe koha e aktivitetit;
- Çmimi aktual për pozicionin e realizuar.

**Plani ditor:** Operatori ekonomik do të ofrojë për çdo ditë në ora 08:00 Planin e punës për ditën aktuale. I njëjti duhet të përmbajë edhe listën e punëtorëve të angazhuar, përfshirë orarin dhe lokacionin e veprimit.

**Raportimi ditor i punës:** Operatori ekonomik do të ofrojë për çdo ditë në ora 16:00 një raport me shkrim dhe me fotografi për t'i dokumentuar të gjitha punët e kompletuara në ditën aktuale.

**Raportimi javor:** Operatori ekonomik do të ofrojë çdo të hënë në ora 09:00 një raport me shkrim dhe me fotografi për t'i dokumentuar të gjitha punët e kompletuara gjatë javës së shkuar, përfshirë ditët e fundjavës. I njëjti duhet të përfshijë punët dhe aktivitetet në realizim e sipër me sqarime të shkurtra përshkruese si dhe përshkrime po ashtu të shkurtra mbi punët e përfunduara.

**Evidenca inspektive punëve në mirëmbajtjen e HHP-ve:** Do të ketë prezencë në terren për kontrole rutinore, për ta vlerësuar nivelin e shërbimeve, afatet kohore, për t'i identifikuar defektet e mundshme, dhe për komunikim direkt me operatorin ekonomik dhe për instruksione apo sugjerime eventuale.

**Inspektimi dhe pranimi i punëve:** Inspektime të rregullta në terren aplikohen gjatë mirëmbajtjes ditore dhe në periudha të caktuara kohore. Inspektime përfundimtare bëhen në fund të periudhave të caktuara kohore (javore, mujore apo sezonale). Inspektori apo mbikëqyrësi duhet të jetë i njoftuar mirë dhe i familjarizuar me Planin aktual për Mirëmbajtjen e HHP-ve dhe me specifikimet teknike për të gjitha pozicionet gjegjëse të mirëmbajtjes. Inspektimi përfundimtar bëhet me rastin e kompletimit të pozicioneve të caktuara dhe pranimi të punëve të kryera, përfshirë mangësitë eventuale të evidencuara dhe të rekomanduara për përmirësim.

## 9. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Përfshirja e komunitetit në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e HHP-ve është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ajo shërben si mjet për ta përfituar mbështetjen publike dhe si shtytje për t'i ngritur çështjet në nivel të agjendave të politikës lokale.

Në këtë kontekst, drejtorit gjegjëse në komunë bashkë me komunitetin dhe me organizatat që veprojnë në mbrojtjen e mjedisit, mund të planifikojnë ngjarje të ndryshme kulturore në data të caktuara si për shembull: Dita e Pranverës, Dita e Tokës, etj. Përmes tyre do të përkujtonin njohuritë themelore dhe do të nxisnin vëmendjen tek publiku lidhur me mjedisin në të cilin qytetarët kalojnë kohën e tyre të çmueshme. Strategjia komunale në këtë aspekt do të mund të aplikohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme publike si:

- Ndërgjegjësimi për mjedisin nëpërmjet edukimit;
- Aksione të përbashkëta me shoqërinë civile.

## 10. PLOTËSIMI DHE REVIDIMI I PMHHP DHE PIHHP

**Plotësimi i planit** i referohet ndryshimeve të vogla në plan të cilat mund të zënë vend pas ciklit të parë të projektit (viti i parë i zbatimit).

**Revidimi i planit** i referohet ndryshimeve të mëdha dhe substanciale të planit, si pasojë e ndryshimeve thelbësore të qëllimeve dhe objektivave. Revidimi është proces interaktiv dhe konsiston në hapat e njëjtë, si ato të aplikuar gjatë hartimit për mirëmbajtjen e HHP-ve.

**Shtojcat:**

**Shtojca 1:** Hartat Tematike (shembulli nga PMHHP i Lipjanit);


**Shtojca 2:** Tabelat e inventarizimit të HHP-ve;

**Shtojca 3:** Formulari i afateve kohore për monitorimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes;

**Shtojca 4:** Përshkrime teknike tipike për mirëmbajtjen e gjelbërimit në HHP.

# Shtojca 1

Fig. 8: Harta tematike



Komuna Lipjan  
Baza e të dhënave të HHP  
H01-Pozita Gjeografike

Fig. 9: Harta tematike - Zona urbane





Fig. 10: Harta tematike/Kategorizimi I HHP-ve







## Shtojca 4: Përshkrime teknike tipike për mirëmbajtjen e gjelbërimit në HHP

### Investues:

#### Projekti: Mirëmbajtja e Hapësirave të Hapura Publike

Formulimi i një sistemi gjithëpërfshirës i cili do t'i shërbejë drejtorive komunale përgjegjëse për mirëmbajtjen e HHP-ve është parë si nevojë aktuale. Për ta mbështetur komunën në definimin e një qasjeje standarde në nivelin lokal, dy modele/nivele tipike të mirëmbajtjes janë propozuar për zbatim. Modele dhe elemente të tjera mund të shtohen më tej në mënyrë që të bëhet një program i mirëmbajtjes bazuar në të cilin do të ishte përgatitur edhe buxheti për mirëmbajtjen e HHP-ve.

Ndryshimi midis këtyre dy të ashtuquajturave klasa/nivele të mirëmbajtjes qëndron në qasjen drejt mirëmbajtjes së HHP-ve, në intensitetin e mirëmbajtjes dhe në frekuencën e aktiviteteve. Disa nga HHP-ve mund t'i përgjigjet më saktë apo më pak njeri nga opsionet e përshkruara. Çmimet për njësi për mirëmbajtje mund të ndryshojnë nga vendi në vend apo nga modeli në model për shkak të fuqisë së angazhuar punëtore, çmimit të materialeve në treg, nivelit të projektit, kohëzgjatjes, lagështisë së ambientit, intensitetit të shfrytëzimit të HHP-ve, etj.

Do të ishte e dëshirueshme që të përcaktohen vlera standarde për mirëmbajtje me qëllim të normalizimit të tyre gjatë cikleve përsëritëse të planit. Përshkrimet standarde të përmendura mund të na shërbejnë në të ardhmen edhe si kritere matëse për vlerësimin dhe monitorimin e mirëmbajtjes së HHP-ve.

Nr. rendor	Përshkrimi i aktiviteteve të mirëmbajtjes
1.	<b>Modeli I:</b>
	Mirëmbajtje e aplikuar në peizazhet me cilësi të lartë dhe të llojlojshme, referuar zonave urbane me qarkullim të lartë, të tilla si, sheshet publike, qendrat, hapësira qeveritare apo parqet me frekuencë të lartë vizitash..

1.1.	<b>Sipërfaqet me bari</b> - lartësia e barit sipas llojit/varietetit. Kositja së paku një herë në pesë ditë apo edhe më shpesh (në tri ditë). Ajrosja sipas nevojës, por jo më rrallë se dy herë në vit. Rimbjellja sipas nevojës. Kontrolli i barishteve të këqija ashtu që prezenca e tyre të jetë jo më shumë se 5% e sipërfaqes.
1.2.	<b>Plehërimi</b> - sipas kërkesave optimale për llojin e caktuar dhe ashtu që të sigurojë ushqyeshmerinë e mjaftueshme gjatë tërë vitit. Përqindja e azotit, fosforit dhe e kaliumit, sipas rekomandimeve për shërbimet gjegjëse. Drunjtë, shkurret dhe lulet të plehërohen sipas nevojës për rritje optimale.
1.3.	<b>Ujitja</b> - me spërkatje automatike apo manuale mund të jetë adekuate. Frekuenca e aplikimit sipas nevojës dhe varësisht nga reshjet, temperaturat, dhe kushtet sezonale.
1.4.	<b>Mbledhja e mbeturinave</b> - së paku një herë në ditë, shtatë ditë në javë. Në hapësira të vizituara me intensitet të lartë edhe më shpesh. Pikat e grumbullimit dhe shportat të jenë të mjaftueshme për t'i pranuar mbeturinat pa derdhje evidente.
1.5.	<b>Krasitja</b> - frekuenca diktohet sipas llojit dhe varietetit të drunjve dhe shkurreve, dhe sipas kërkesave të projektit (të formësuara apo natyrale). Krasitja të bëhet në periudhat e vegjetacionit të pushuar.

1.6.	<b>Kontrolli ndaj insekteve dhe sëmundjeve</b> - mund të jetë: 1) preventiv: sipas ndonjë programi të paracaktuar; 2) korrektues: me mjete kimike apo mekanike për t'i eliminuar problemet e vërejtura; 3) pa aplikim të ndonjë mase të caktuar përderisa nuk vërehen dëmtime konkrete në drunjë apo gjelbërime, apo përderisa insekte të ndryshme nuk irritojnë dukshëm. Parashihet që problemet të parandalohen apo të vërehen dhe të evitohen në fazë të hershme.
1.7.	<b>Largimi i borës</b> - duhet të fillojë menjëherë pasi të jetë akumuluar të trashësi prej 5cm. Assesi nuk lejohet që bora t'i mbulojë rrugët, shtigjet dhe hapësirat për parkim të automjeteve më gjatë se në drekën e ditës pasuese nga pushimi i reshjeve. Aplikimi i kripërave dhe rërës konsiderohet i përshtatshëm për ta zvogëluar rrezikun e lëndimeve nga rrëshqitja.
1.8.	<b>Ndriçimi</b> - mirëmbajtja duhet të sigurojë qëllimin e projektit. Sistemet e dëmtuara duhet të riparohen menjëherë pasi të jenë vërejtur. Ndërrimi i poçeve duhet të bëhet ditën e parë të punës pas raportimit të prishjes.
1.9.	<b>Sipërfaqet</b> - fshirja, pastrimi dhe larja e sipërfaqeve duhet të bëhet ashtu që akumulimet e rërës, ndyrësisë dhe/apo gjetheve në asnjë kohë të mos krijojnë përshtypje të pakëndshme apo të pasigurisë në hapësirë. Fshirja apo ngjyrosja e njollave në strukturat ekzistuese duhet të aplikohet sa herë që sipërfaqet shihen të dëmtuara nga ndikimet atmosferike apo të konsumuara me kohë. Ngjyrosja e sipërfaqeve të punuara me dru bëhet së paku një herë (apo dy herë) në vit. Njollat nga sipërfaqet e shtruara duhet të largohen/pastrohen apo të ngjyrosen brenda pesë ditësh nga momenti i identifikimit.
1.10.	<b>Riparimet</b> - riparimet e të gjitha elementeve përbërëse duhet të bëhen menjëherë pasi të jenë vërejtur po që se pjesët zëvendësuese dhe punëtorët janë në dispozicion. Kur riparimet janë kritike dhe mund të paraqesin pengesa për shfrytëzuesit, të njëjtat mund të shtyhen për një periudhë më të përshtatshme.
1.11.	<b>Inspektimi</b> - inspektimet e hapësirave nga personi përgjegjës duhet të jenë të përditshme.
1.12.	<b>Lulet/shtretër lulesh</b> -- kujdesi me ujitje, plehërim, kontroll ndaj sëmundjeve dhe bar-ishteve të këqija është patjetër i nevojshëm dhe atë së paku një herë në javë. Stan-dardi i dëshirueshëm duhet të jetë gjendja e luleve të freskëta dhe pa barishte të këqija.
1.13.	<b>Hapësirat e mbuluara për pushim</b> - jo gjithmonë pjese të projekteve por aty ku ekzistojnë, atyre duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë dhe pastrim i përditshëm, sidomos ditëve me frekuentim tepër të lartë.
1.14.	<b>Elemente tjera mikrourbane</b> - elemente si fontana, kroje me ujë të pijshëm, skulptura, vepra arti, shtylla flamujsh, barriera kontrolluese etj., mund të jenë pjesë e projekteve integrale dhe të njëjtat po ashtu kërkojnë mirëmbajtje e cila për hapësirat e klasit të parë mund të jene të rëndësishme relativisht të larta.

<b>2</b>	<b>Modeli II:</b>
	Nivel mesatar i mirëmbajtjes i ndërlidhur me lokacionet me zhvillim mesatar apo të ulët, të vizituara me frekuencë mesatare apo të ulët, me kapacitete të kufizuara buxhetore për mirëmbajtje.

2.1.	<b>Sipërfaqet me bari</b> - lartësia e barit sipas llojit/varietetit. Kositja se paku një herë në 10 ditë. Ajrosja nuk aplikohet përveç nëse kualiteti i dobët i sipërfaqes nuk imponon atë apo plehërimin e hapësirës. Rimbjellja vetëm kur vërehen sipërfaqe të mëdha të zhveshura. Masa kontrolli kundrejt barishteve të këqija atëherë kur më shumë se 50% e sipërfaqeve të vogla mbulohet me to apo kur 15% e më tepër nga sipërfaqja e përgjithshme mbulohet me kualitet të dobët.
2.2.	<b>Plehërimi</b> - vetëm atëherë kur bari nuk ka fuqi të zhvillohet normalisht. Plehërim i rrallë, një herë në vit. Norma e sugjeruar, gjysma e sasisë së paraparë për hapësirat e klasit të parë.
2.3.	<b>Ujitja</b> - varësisht nga klima mbizotëruese. Hapësirat mbështeten në reshjet atmosferike me ujitje eventuale plotësuese gjatë periudhave të thata. Kur është e nevojshme, frekuenca e normuar do të ishte një deri në dy herë (apo ndoshta, dy deri në tri herë) në javë.
2.4.	<b>Mbledhja e mbeturinave</b> - së paku dy deri në tri herë në javë. Frekuenca më e madhe e përdorimit mund të diktojë mirëmbajtje më të shpeshtë gjatë periudhave të nxehta sezonale.
2.5.	<b>Krasitja</b> - kur shihet e nevojshme për arsye shëndetësore apo për efekte të pamjes dhe vizurave. Për shumicën e drunjve dhe shkurreve, jo më shpesh se një herë në dy apo tri vite.
2.6.	<b>Kontrolli ndaj insekteve dhe sëmundjeve</b> - vetëm në rast të ndonjë epidemie apo në bazë të ankesave serioze. Masa kontrolli mund të aplikohen kur ekzistenca e drunjve është e kërcënuar apo kur komoditeti i shfrytëzuesve vjen në pyetje.
2.7.	<b>Largimi i borës</b> - bazuar në kërkesat sipas ligjeve lokale por në përgjithësi duhet të aplikohet në ditën pas reshjeve të borës. Disa nga sipërfaqet apo shtigjet mund të mos pastrohen fare.
2.8.	<b>Ndriçimi</b> - ndërrimi i poçeve bëhet kur vërehen prishje/djegje apo pasi të raportohen prishjet.
2.9.	<b>Sipërfaqet</b> - fshirja bëhet në bazë të ankesave. Riparimi apo zëvendësimi bëhet varësisht nga buxheti.
2.10.	<b>Riparimet</b> - bëhen kurdo që siguria apo funksioni të vihet në pikëpyetje.
2.11.	<b>Inspektimi</b> - bëhet një herë në javë.
2.12.	<b>Lulet/shtretër lulesh</b> - kërkohet vetëm mirëmbajtje e bimëve shumëvjeçare.
2.13.	<b>Hapësirat e mbuluara për pushim</b> - kur ekzistojnë, mirëmbahen së paku dy herë në javë. Sipas rasteve edhe më shpesh.
2.14.	<b>Elemente të tjera urbane</b> - mirëmbajtje minimale duke pasur parasysh funksionin dhe sigurinë e shfrytëzuesve.



Hartimi i Planit për Mirëmbajtjen dhe  
Planit për Invesime në  
Hapësira të Hapura Publike

Udhëzues për komunat në Kosovë



**HELVETAS**  
Swiss Intercooperation

KOSOVO



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Cooperation Office Kosovo**